



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDËTËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org. Jedinica Org Unit	02
Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	05-3465
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-1-
Data: Datum: Date:	08/05/2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm – Ured Generalnog Sekretara –Office of the General Secretary

Nr.346/V/2024
Datë:07/05/2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), në zbatim të Nenit 25 të Ligjit Nr. 08/L -017 për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Plani i Integritetit Institucional 2024 – 2026.
- II. Shtojcë e këtij vendimi është Plani i Integritetit Institucional 2024 – 2026.
- III. Shfuqizohet vendimi me nr. protokollit 05-3418 i datës 07.05.2024.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Dr. Naim Bardiqi

Sekretar i Përgjithshëm

Vendim i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Lulëzim Uka, Kryesues i Grupit Punues
- Departamentit ligjor;
- Arkivit të MSh-së.



PLANI I INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

2024 - 2026

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Prishtinë, Maj 2024

Përmbajtje

I. Deklarata e Integritetit	3
II. Hyrje.....	4
III. PLANI PËR INTEGRITET	5
IV. Sfondi.....	7
V. Parimet e menaxhimit të integritetit.....	8
V.1. Udhëheqja	8
V.2. Përfshirja e personelit	8
V.3. Qasja sistemore.....	8
VI. Objektivat e Planit të Integritetit.....	8
VII. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit	10
VII.1. Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit	10
VII.2. Metodologjia e vlerësimit të rrezikut.....	11
VII.3. Matrica vlerësimit të rrezikut	11
VII.4. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut.....	12
VIII. Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi.....	13
IX. Fushat e rrezikut	14
Fushat e përgjithshme të rrezikut.....	14
Fushat specifike të rrezikut	14

I. Deklarata e Integritetit

Plani i integritetit i Ministrisë së Shëndetësisë synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate profesionale dhe të modernizuar në funksion të politikave shëndetësore me qëllim të ofrimit të shërbimeve profesionale për të gjithë qytetarët.

Përmes Planit të integritetit, do të promovohet transparenca dhe llogaridhënia në mënyrë që Ministria e Shëndetësisë të përmbushë rolin e saj për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese, dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor..

Plani i integritetit është hartuar me qëllim të zbatimit të dispozitave ligjore të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim Ligji), gjegjësisht nenit 25, në të cilin parashihet roli kyç i administratës shtetërore në zhvillimin dhe implementimin e kornizës së integritetit përmes promovimit të integritetit, ndershmërisë dhe përgjegjësisë për të gjithë zyrtarëve publikë.

Ministria e Shëndetësisë përmes këtij plani synon promovimin e profesionalizmit, efikasitetit dhe kulturës organizative me theks te llogaridhënia dhe transparenca në raport me qytetarët me qëllim që të kthejmë integritetin dhe etikën në shtylla kyçe të sistemit tonë të menaxhimit.

Ministria e Shëndetësisë me përkushtim do të zhvillojmë më tej kapacitetet administrative dhe personelin, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha sfidave që kanë të bëjnë me integritetin, si dhe për të menaxhuar në mënyrë adekuate rreziqet e shumta e të ndryshme të integritetit me të cilat ne ballafaqohemi.

Me plan të integritetit, synojmë që të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standarde, parime dhe objektiva në parandalimin e korrupsionit dhe sjelljet e tjera të paligjshme dhe joprofesionale. Duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, ne forcojmë integritetin dhe kulturën për parandalim të korrupsionit në punën e organeve të administratës në Ministrinë e Shëndetësisë. Përmes mekanizmave të rreshtuar si aktivitete në Planin e integritetit, Ministria do të synoj të eliminojë shkaqet e korrupsionit rrjedhimisht forcimin e sundimit të ligjit dhe rritjen e besimit të qytetarëve në punën e administratës së MSh-së.

Duke qenë të vetëdijshëm se menaxhimi i rrezikut të integritetit nuk duhet të jetë një veprim i vetëm, por një proces i vazhdueshëm që përkrah zhvillimin dhe zbatimin e Planit të integritetit, do të zbatojmë masat e planifikuara, por edhe të bëjmë përpjekje për të integruar menaxhimin e rrezikut ndaj integritetit në kulturën organizative të Ministrisë së Shëndetësisë në mënyrë të qëndrueshme. Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit.

Ministria e Shëndetësisë do të përfaqësoj interesat e qytetarëve, duke ju përmbajtur vazhdimisht etikës dhe standardeve profesionale mbi bazën e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Andaj, ne besojmë që ky Plan i integritetit do të jetë një ndihmesë në luftën për parandalimin e korrupsionit, në krijimin e një kulture organizative të punës dhe respektimit të kodit etik, në mënyrë që qytetarëve t'u kthehet edhe më shumë besimi në punën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe njëkohësisht shprehim gatishmërinë dhe përkushtimin e duhur për të gjitha përpjekjet për të fuqizuar dhe përmirësuar vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit.

II. Hyrje

Në pajtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht me obligimin sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, gjegjësisht nenit 25, që të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Ministria e Shëndetësisë ka hartuar dhe miratuar Planin e integritetit për periudhën 2024 -2026.

Planin e integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë dhe të korupsionit ekspozimin ndaj praktikave jo etike dhe të korupsionit. Planin është dokument operativ, që për të arritur qëllimet masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ballafaqimi efektiv me korupsionin potencial në sistemin tonë shëndetësor është me rëndësi shëndetësore etike për të arritur rezultate më të larta në shëndetësi me qëllim që të mundësoj shërbime me cilësi të mira për të gjithë qytetaret në Republikën e Kosovës. Intervenimet efektive për tu ballafaquar me këto dobësi mund të sjellin deri te arritja e rezultateve me të mira në shëndetësi.

Në Kosovë autoriteti më i lartë, Ministria e Shëndetësisë, ka përgjegjësinë kryesore për të krijuar politika dhe për të bërë monitorimin e zbatimit të këtyre politikave, që rrjedhimisht do të ndikojnë edhe në luftën për parandalimin e korupsionit potencial. Zvogëlimi i rrezikut nga korupsioni dhe rritja e efikasitetit të shpenzimeve publike padyshim do të jep rezultate më të mira në shëndetësi. Duke marrë parasysh faktin se korupsioni eventual në sektorin e shëndetësisë do të shkatërronte legjitimitetin dhe besimin publik të institucioneve qeveritare, intervenimet e suksesshme për parandalimin e korupsionit të ndërmarra nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë do të paraqesin përkushtim të Qeverisë dhe do të forcojnë transparencën, si dhe do të rrisin pjesëmarrjen e të gjithë akterëve në sektorin e shëndetësisë në përgjithësi.

Planin e integritetit do të rithekson përkushtimin e Ministrisë së Shëndetësisë për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah qytetari. Planin përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektiveve të Ministrisë dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

Planin e integritetit i Ministrisë së Shëndetësisë ka potencial që gjithashtu të influencoj pozitivisht agjendën për parandalimin e korupsionit në nën-segmente specifike të sektorit të shëndetësisë në përgjithësi.

Ky plan do të paraqes bindjen e plotë në integritet të deklaruar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, që është e përcaktuar të mbaj qëndrim pro aktiv ndaj shkeljeve potenciale të integritetit, si dhe të siguroj se sukcesi i masave të sipërme reformuese nuk është viktimë e kërcënimeve ndaj integritetit, që bëhet përmes masave abuzive të grupeve të fuqishme të interesit, apo abuzimeve dhe rezistenca nga brenda institucionit. Ministria e Shëndetësisë duke u përkushtuar në zbatimin e legjislacionit dhe në aktivitetet që adreson Planin e integritetit institucional synon të arrijë rezultate të qëndrueshme.

III. PLANI PËR INTEGRITET

Plani për integritet është një dokument strategjik dhe operativ që konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e integritetit institucional. Ky plan kuptohet si një respektim i drejtpërdrejtë i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative. Gjithashtu, plani ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Plani i integritetit mundëson:

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në të gjitha fushat e punës në Ministri;
- Vlerësimin e çfarëdolloj rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit, jo-profesionalizmit apo sjelljeve jo-etike për Ministrinë; dhe
- Përcaktimin e masave për të parandaluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit, sjelljeve tjera jo-profesionale dhe jo etike.

Plani i Integritetit do të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:

- Rritjen e mundësive që Ministria e Shëndetësisë të arrijë objektivat e saj organizative, duke vënë përpara një menaxhim pro aktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësoj rezistencën organizative ndaj korrupsionit potencial dhe do të zvogëloj mundësitë për korrupsion potencial;
- Përqendrimin tek prioritetet, në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do t'i ndihmojnë Ministrisë të shpërndajë në mënyrë efektive burimet në dispozicion për parandalim të korrupsionit potencial, që të shfrytëzohen në mënyrën më mirë të mundshme;
- Përmirësimin e kontrolleve operative ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
- Mbjajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm për parandalim të korrupsionit përmes trajnimit të synuar dhe ndërgjegjësimit, si dhe duke inkurajuar një bashkëpërgjegjësi i të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planit të integritetit;
- Rritjen e besimit të zyrtarëve të organizatës dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstron nga Ministria e Shëndetësisë.

Me zbatimin e këtij plani, Ministria do të vendoset më mirë për të siguruar një shpërndarje efektive, efikase, transparente dhe etike të rezultateve të synuara, përfshirë hartimin dhe monitorimin e politikave me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore dhe të sigurta për të gjithë qytetarëve. Gjithashtu, Ministria do të jetë në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara, përfshirë këtu shërbimet më të mira për qytetarët dhe rritje të kënaqshmërisë nga ana e qytetarëve dhe grupeve të interesit.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi të vlerësimit të rrezikut të bërë nga Ministria. Prosesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të Ministrisë në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre, duke marrë parasysh dëmet materiale dhe jo materiale, që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe gjasat, që ngjarje të tilla mund të ndodhin duke parë rezistencën aktuale organizative të vërtetuar në rregulloret, procedurat, kodet, praktikatat dhe përfshirjen e punonjësve.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi vlerësimi të rrezikut që Ministria e Shëndetësisë e ka bërë në periudhën 2024- 2026. Prosesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta në organizatë rastet potenciale të shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh (1) dëmet materiale dhe jo - materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe (2) gjasat që këto ngjarje të ndodhin prapë nga rezistenca aktuale organizative e vërtetuar nga rregulloret, procedurat, kodet, praktikatat relevante dhe nga përfshirja e stafit.

IV. Sfondi

Për të pasur një pasqyre të qartë për nevojën e zhvillimit të integritet institucional në Ministrinë e Shëndetësisë, është parashtruar domosdoshmëria për një analizë të sektorit për të parë identifikimin e pikave të dobëta dhe nevojën e intervenimeve specifike me qëllim që orientimit të veprimeve që do të adresojnë çështjet e transparencës dhe llogaridhënies.

Për këtë qëllim është zhvilluar një pyetësor nga konsulentët e USAID i cili është shpërndarë te të gjitha institucionet administrative në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë për të vlerësuar se cilat fusha funksionale kanë nevojë për intervenim.

Pas mbledhjes së të dhënave nga pyetësorët, në masë të madhe ka dalë në pah nevoja për forcimin e qëndrueshmërisë operative ndaj shkeljeve të integritetit dhe për zvogëlimin në mënyrë efikase të rreziqeve të ndërlydhura, ku shumica e të anketuarve kanë listuar se koordinimi i planifikimit të burimeve njerëzore, administrimi i rekrutimit të personelit, kontributi në rritjen e performancës së personelit nëpërmjet motivimit dhe zhvillimit të planeve trajnuese duhet të adresohet në planin e veprimit për integritet institucional.

Të dhënat nga pyetësorët tregojnë se shumica e të anketuarve kanë nevojë për trajnime të cilat do të ndihmonin organizatën për të identifikuar veprimet për integritetin institucional me qëllim të adresimit në mënyrë të drejtë në zgjidhjen e dilemave etike me theks trajnime lidhur me kodin e etikës.

Por, nga të dhënat e marra nga pyetësorët është shqetësues fakti se asnjë nga të anketuarit nuk ka hasur në raportim të ndonjë rasti të shkeljes së integritetit apo, që vet kanë raportuar raste të tilla.

Gjithashtu të dhënat nga pyetësori kanë treguar se në njësi përkatëse brenda organizatës, ka dyfishim të përgjegjësisë, që vështirëson dhe pengon llogaridhënien dhe transparencën.

Të dhënat nga pyetësorët kanë identifikuar se ka paqartësi rreth funksioneve, proceseve dhe procedurave, që përshkruajnë proceset e punës dhe detyrat e përgjegjësitë të institucioneve që ofrojnë shërbime shëndetësore, por është e kundërta te institucionet administrative. Gjithsesi kjo nevojitet të adresohet me aktet e brendshme të këtyre institucioneve.

Është inkurajuese që shumica e përgjigjeve nga pyetësorët thekson se ka udhëzime/rregullore të qarta mbi deklarin e konfliktit të interesit, që realisht është një nga elementet më të rëndësishme të integritetit institucional.

Sa i përket mekanizmave të brendshme të organizatave nuk ka njohuri të mjaftueshme për këta mekanizma nga të punësuarit. Prandaj nevojitet që të identifikohen forma për të njoftuar të punësuarit me këta mekanizma, gjithashtu nuk kanë njohuri se a ndërmerren veprime për të korrigjuar sistemet dhe praktikatat.

Sa i përket komunikimit publik të anketuarit kryesisht janë përgjigjur se kanë nevojë për masa të mëtejshme për përmirësimin e integritetit për forcimin e qëndrueshmërisë operative ndaj shkeljeve të integritetit dhe për zvogëlimin në mënyrë efikase të rreziqeve të ndërlydhura përmes ofrimit të mbështetjes profesionale në fushën e komunikimit dhe informimit, hartimit dhe sigurimit të zbatimit të planeve të komunikimit si dhe përgatitja e komunikatave për shtyp, deklaratave, raporteve dhe publikimeve të tjera mediave.

V. Parimet e menaxhimit të integritetit

V.1. Udhëheqja

Menaxhmenti i lartë duhet në mënyrë të dukshme të demonstrojë një përkushtim aktiv të bazuar në fakte për integritetin. Kjo do të kërkonte nga ata që të udhëheqin procesin qysh nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit dhe kodit të etikës. Shumë e rëndësishme është që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm, të kuptohet dhe të shihet mirë nga i gjithë stafi dhe palët e interesit. Kjo do të arrihet përmes një aplikimi sistematik të politikave, procedurave dhe praktikave të menaxhmentit ndaj aktiviteteve të komunikimit, konsultimit, vendosjes së kontekstit, identifikimin, analizimin, vlerësimin, ballafaqimin, monitorimin dhe rishikimin e rrezikut të integritetit. MSh e vetëdijshme për rolin e rëndësishëm që ka si mekanizmi kryesor në sektorin e shëndetësisë, me potencial të gjerë që të influencoj ndërrime pozitive me nxitjen e Planit të integritetit dhe të menaxhmentit, ka tendencë që këtë plan ta përdor si një mekanizëm që të ndiqet edhe nga të tjerët. Përpjekja në zbatimin e planit të integritetit do të inkurajoj dhe motivoj edhe njësitë e sektorëve tjerë publike, përfshirë edhe Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), si dhe institucione shëndetësore relevante që të ndërmarrin masat e nevojshme, që ti përmirësojnë dukshëm rregullat dhe praktikën e tyre për parandalim të korrupsionit, dhe kështu të inkurajoj rezultatet më të mira në shëndetësi.

V.2. Përfshirja e personelit

Pjesëmarrja e gjithë stafit është shumë e rëndësishme në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplote kërkon edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ngritjen e vetëdijes, duke krijuar kështu besim dhe mjedis pozitiv për punë. Komunikimi dhe koordinimi efektiv i brendshëm dhe i jashtëm janë të rëndësishëm për punë të suksesshme ekipore, në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëjtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar. Plani i integritetit nuk është dokument statik, por një dokument monitorimi me një format planifikues, duke u shqyrtuar kohë pas kohe dhe duke u përditësuar në përputhje me kornizën ligjore, me zhvillimet relevante të procedurave institucionale, dhe të personelit brenda dhe jashtë institucionit.

V.3. Qasja sistemore

Identifikimi i fushave potenciale të korrupsionit dhe menaxhimi i proceseve të ndërlidhura për të siguruar integritet kërkon qasje sistemore. Kjo kërkon që Ministria do t'iu kushtojë vëmendje të gjitha njësisve dhe të analizoj marrëdhënien dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre. Plani do të synoj që të zhvillojë qasje sistematike ndaj: mbikëqyrjes, duke vlerësuar dhe komunikuar rezultatet e zbatimit të masave të integritetit nga brenda, përfshirë edhe publikime të raporteve për masat e integritetit si pjesë e raporteve tremujore brenda institucionit dhe raporteve të rregullta në APK bazuar në Metodologjinë e Planit të Integritetit.;

VI. Objektivat e Planit të Integritetit

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe vendos përpjekjet dhe burimet për të parandaluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në Ministri të Shëndetësisë.

Objektiva strategjike I: Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit përmes zbatimit të kornizës strategjike relevante mbi integritetin.

Investimet që bëhen në sektorin e shëndetësisë mund të mos kenë rolin dhe ndikimin e dëshiruar nëse në investimet shëndetësore nuk ndërtohen mekanizmat e brendshme për të adresuar rreziqet korruptive. Masat parandaluese pro-aktive mund ti mbrojnë investimet e bëra. Praktikrat e intervenimeve nga Ministria e Shëndetësisë bëhen pas marrjes së rekomandimeve nga mekanizmat e kontrollit të jashtëm dhe të brendshëm siç është rasti me rekomandimet e auditorit. Mbikëqyrja dhe raportimi i rregullt në Ministrinë e Shëndetësisë për mospërputhjet në procedura dhe standarde operative dhe mungesat në zbatim të tyre janë mekanizma kyç për të adresuar problemet potenciale korruptive. Për këto qëllime, janë paraparë aktivitetet në planin e veprimit.

Objektivat specifike janë:

- I. Rritja e transparencës, përgjegjshmërisë në zbatim ndaj ligjeve dhe rregulloreve, si dhe respektit ndaj personave tjerë;
- II. Rritja e vetëdijesimit të zyrtarëve të MSh-së mbi rreziqet e korrupsionit dhe raportimit të tyre;
- III. Avancimi dhe mbështetja e mekanizmave për raportim të rasteve të korrupsionit;
- IV. Rritjen e besimit të zyrtarëve të organizatës dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstron nga Ministria e Shëndetësisë;
- V. Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve administrative.

Reforma në shëndetësi bazohet në rritjen e transparencës dhe llogaridhënien e ofruesve të kujdesit shëndetësor përmes themelimit të strukturave reja dhe funksionalizimit të strukturave aktuale.

Reforma si tërësi përfshinë:

- Ruajtjen dhe përparimin e shëndetit;
- Ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të sigurt;
- Krijimi i skemës së sigurimeve shëndetësore për të siguruar qasjen në kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët;
- Riorganizimi i sektorit të shëndetësisë

Të gjitha këto zhvillime ofrojnë bazë të shëndoshë për avancimin e agjendës së menaxhimit të institucionit për integritet. Në këtë drejtim, Ministria e Shëndetësisë do të fuqizoj reformën institucionale për të përmirësuar integritetin dhe të parandaloj korrupsionin eventual duke u fokusuar në këto fusha më të rëndësishme:

Rezistencën e forcuar të organizatës ndaj shkeljes së integritetit në MSh përmes kornizës ligjore dhe politikave për integritetin, integrimin dhe rritjen e efikasitetit dhe transparencës në të gjitha funksionet e saja. Pra, rrjedhimisht, duke e integruar menaxhmentin e rrezikut të integritetit si element thelbësor i përgjegjësisë së menaxhimit dhe udhëheqjes, rezistencën e shtuar ndaj shkeljeve të integritetit përmes forcimit të kontrollit të integritetit operativ në fushat kyçe të mbikëqyrjes dhe nën-fushave, që janë të ndjeshme ndaj korrupsionit me qëllim të ndërtimit dhe forcimit të burimeve të brendshme njerëzore, të nevojshme dhe të duhura për zbatimin e

objektivave të integritetit. Kjo praktikë në mënyrë indirekte do të ndikoj në institucionet shëndetësore në sektorin publik, që t'i mundësohet stafit të kuptojnë çështjet e integritetit, t'i aplikojnë rregullat relevante të mbikëqyrjes së zbatimit, si dhe të ndërmarrin veprime të nevojshme përmirësuese dhe parandaluese. Mbështetjen e kulturës së integritetit në të gjithë sektorin e shëndetësisë në Kosovë me praktika të mira, por edhe duke vlerësuar zbatimin dhe ndikimin e institucioneve të integritetit dhe masat për mësim të vazhdueshëm të politikave dhe përshtatjen e tyre.

Plani i Integritetit Roli i MSh si autoritet kyç në zbatimin këtij Plani që ka rol në parandalimin e korrupsionit do të jetë një vendimtar. Në këtë drejtim, përpos masave institucionale që duhet të ndërmerrin vetëm MSh, por edhe nga MSh, për të përmirësuar rezistencën e vet si organizatë ndaj shkeljeve të integritetit, Plani i Integritetit përparshëm që MSh të ndërmerret edhe masa të cilat kanë qëllim ndikimin edhe në institucionet e tjera publike, në këtë rast në institucionet shëndetësore publike dhe Fondin e Sigurimit Shëndetësor.

Integriteti VII. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument që është hartuar në bazë të vlerësimit të integritetit të punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si Ministria dhe punonjësit e saj veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe/ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i rreziqeve të identifikuara dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të Ministrisë së Shëndetësisë; dhe
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar rreziqet e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit është bërë vlerësimi i rreziqeve të integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të administratës në Ministrinë e Shëndetësisë. I gjithë stafi i Ministrisë ka marrë pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të ministrisë dhe ka propozuar masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve. Ky proces është realizuar për herë të parë në Ministrinë e Shëndetësisë në vitin 2022 ku është aprovuar lista e rreziqeve. Po ashtu Ministria në kuadër të planifikimit vjetor të aktiviteteve për secilin departament dhe njësi ka paraparë edhe rreziqet.

VII.1. Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit në ministri është realizuar në disa faza, si në vijim:

- **Faza përgatitore** – Sekretari i përgjithshëm ka themeluar grupin e punues ku është përcaktuar struktura e grupit punues dhe kryesuesi i tij. Grupi punues ka mbledhur informacione të nevojshme për zhvillimin e planit të integritetit si dhe ka njoftuar të gjithë stafin për rëndësinë e Planit të Integritetit. Ministria e Shëndetësisë meqenëse dhe me herët ka pasur plan të integritetit institucional, këtë proces e ka hartuar dhe dizajnuar me lehtë, por edhe duke marrë mbështetjen me asistencë teknike nga USAID.
- **Faza e vlerësimit të rrezikut të integritetit** – gjatë kësaj faze kryesuesi së bashku me grupin punues kanë analizuar dokumentacionin e mbledhur (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së Ministrisë, përshkrimet e vendit

të punës dhe fushëveprimin e çdo njësie të Ministrisë), si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale janë përcaktuar fushat e rrezikut dhe është bërë identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve.

- **Faza e përcaktimit të prioriteteve dhe propozimit të masave për përmirësimin e integritetit** – Ministria e Shëndetësisë përmes grupit punues i cili është takuar në bazë të vlerësimit të Kryesuesit së paku njëherë në javë, ka përcaktuar prioritetet për intervenimin, përcaktimin e masave për parandalimin/eliminimin e rreziqeve dhe zyrarët përgjegjës për zbatim. Pas hartimit të draftit fillestar Plani i Integritetit i është përcjellë për konsultim final të gjitha njësive/departamenteve të MSh për të marrë komentet e fundit dhe finalizimin e planit.

Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të integritetit – Ministria e Shëndetësisë si pjesë e vazhdimësisë së monitorimit të zbatimit të Planit të integriteti institucional ka caktuar zyrtarin përgjegjës brenda administratës, që është përgjegjës për monitorimin, vëzhgimin dhe regjistrimin e rregullt të aktiviteteve që ndodhin në një Plan të Integritetit dhe procesin e mbledhjes së informacionit për të gjitha aspektet e zbatimit të Planit të Integritetit. Ndërsa, sipas Vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm raportimi i procesit është i rregullt, që rrjedhimisht mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve, që rezultojnë në zbatimin e objektivave të Planit të Integritetit.

VII.2. Metodologjia e vlerësimit të rrezikut

Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm që janë identifikuar dhe aprovuar.

Kjo ka qenë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, prioritetet janë përcaktuara ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, janë vendosur aty ku ndihet më së shumtë se janë më të nevojshme. Në përgjithësi, rreziqet e kategorizuara si të vogla, janë në përputhje me standardet për marrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit.

Në anën tjetër, rreziqet madhore kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masat adekuate, për të cilat Ministria është vetëdijshme dhe do të kushtojë rendësi të veçantë.

Pas përcaktimit të dy parametrave, gjasave të ndodhjes së rrezikut dhe pasojave (ndikimit) të rrezikut të ndodhur, grupi punues ka përcaktuar nivelin e rrezikut për të gjitha rreziqet e identifikuar dhe të vlerësuara, duke përdorur Matricën e Rrezikut. Niveli përfundimtar i rrezikut është përcaktuar bazuar në Matricën e Rrezikut si kombinim i gjasave dhe pasojave.

VII.3. Matrica vlerësimit të rrezikut

Matrica e vlerësimit të rrezikut ka mundësuar të llogaritet rreziku në fushat apo aktivitetet e Ministrisë për një kohë shumë të shpejtë, duke identifikuar të gjitha gjërat që mund të shkojnë keq dhe duke përshkruar dëmin e mundshëm. Kjo ka bërë më të lehtë priorizimin e çështjeve dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe masave aty ku është më e nevojshme për të mbajtur fushën, aktivitetin e njësive brenda Ministrisë në rrugë të mbarë.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

Pasoja /Ndikimi	Madhor	10									
		9									
		8									
	Mesatar	7									
		6									
		5									
		4									
	Vogël	3									
		2									
		1									
Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)		Ulët			Mesatar				Lartë		
		Probabiliteti/Gjasat									

Intenziteti i rrezikut është fituar duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

VII.4.Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, është vlerësuar nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

■ Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

■ Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

■ Rreziku me intensitet të lartë – Korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

VIII. Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizmat përkatës tashmë të themeluar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm dhe do të rishikohet periodikisht, si dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të administratës dhe njësiteve përbërëse të Ministrisë së Shëndetësisë. Raportimi do të bëhet sipas përcaktimit ligjor bazuar në Ligjin Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, rrjedhimisht raportet do të publikohen sipas përgjegjësisë ligjore.

Po ashtu me qëllim të monitorimit më efikas, raportimi brenda institucionit, do të jetë në faza brendshëm tremujore i cili do të përcillet te mekanizmi i brendshëm monitorues për monitorimin e zbatimit të politikave institucionale.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në projektim ashtu edhe në funksionim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi do të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rrezikut të integritetit kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioritetëve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimë duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit, raporti do të dërgohet për diskutim në mekanizmat më të lartë administrativ të Ministrisë së Shëndetësisë.

Pra, me qëllim të sigurimit të zbatimit të Planit të Integritetit, janë themeluar mekanizmat për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e Planit të Integritetit, si në vijim:

1. **Grupi punues** - është emëruar me vendim të sekretarit të përgjithshëm dhe është përgjegjës për të evidentuar:
 - promovimin e integritetit në Ministri të Shëndetësisë dhe merr masa për të parandaluar korrupsionin potencial, konfliktin e interesit dhe format e tjera të sjelljeve jo etike;
 - hartimin e draftit të Planit të Integritetit institucional;
 - përgatitjen e programit për hartimin e planit të integritetit;
 - siguron që Plani i integritetit të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi, standardet e punës, metodat e vlerësimit të integritetit dhe me metodat e riparimit;
 - zhvillimin e një qasje sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të integruar ndaj rreziqeve;
 - propozimin e masave të nevojshme për eliminimin dhe parandalimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;

Grupi punues mbaron mandatin pas hartimit të planit të integritetit institucional të Ministrisë së Shëndetësisë. Sekretari i Përgjithshëm themelon grupin e ri punues varësisht nga vlerësimi i nevojave.

2. **Koordinatori për mbikëqyrje të integritet** – është emëruar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm dhe është përgjegjës për:

- përgatitur metodologjinë për monitorimin e Planit të Integritetit;
- raportimin mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- të mbledhur dhe analizuar dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me funksionimin e organeve të Ministrisë, i cili është baza për vlerësimin e rrezikut dhe zhvillimin e Planit të integritetit;
- pranimin dhe rishikimin e informacionit për situatat, ndodhitë dhe veprimet për të cilat ekziston një besim i arsyeshëm se ato përfaqësojnë një mundësi për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;
- përgatitë dhe shpërndan pyetësorin si dhe zhvillon intervistat me stafin e administratës së ministrisë, me qëllim të mbledhjes së informatave për hartimin e Planit të Integritetit;
- në bashkëpunim me të gjitha njësitë organizative, përgatit raportet për zbatimin e planit të integritetit;
- sigurimin e zbatimit, azhurnimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të Planit të integritetit si dhe standardet, format dhe procedurat për të mbështetur Planin e integritetit;
- harton raporte periodike për monitorimin e planit të integritetit dhe i raporton ZKA.

Koordinatori, gjithashtu, mbështet grupin punues në hartimin dhe përgatitjen e raporteve për zbatimin e Planit të Integritetit. Koordinatori i rekomandon Sekretarit të Përgjithshëm për takim me grupin punues sa herë që vlerësohet e nevojshme.

IX. Fushat e rrezikut

Fushat e përgjithshme të rrezikut

Fushat e përgjithshme të rrezikut janë:

- Drejtimi dhe menaxhimi;
- Planifikimi dhe menaxhimi financiar;
- Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve;
- Komunikimi dhe informimi;
- Ruajtja dhe siguria e të dhënave.

Fushat specifike të rrezikut

Fushat e specifike të rrezikut janë:

- Prokurimi publik dhe menaxhimi i projekteve/kontratave.
- Furnizimi me barna
- Inspektimet

Planit i Integritetit

Fushat e përgjithshme të rrezikut

Identifikimi i rrezikut		Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut			
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
Drejtimi dhe menaxhimi	Mos hartimi i legjislacionit	Monitorimi i zbatimit të programit dhe planit legjislativ	4	8	32	Prioritizimi i ligjit bazik;	ZKA	Janar 2024
						Shfrytëzimi i drafteve të viteve të kaluara;	Zyrtari përgjegjës për hartimin e politikës	Tetor 2024
						Shfrytëzimi i memories institucionale.	Zyrtari përgjegjës për hartimin e politikës	Mars 2024
	Mos miratimi i politikave	Planifikimi bazuar në dokumente ndër sektoriale	8	8	64	Hartimi SSSH 2030; Hartimi i planeve strategjike mbi bazën e SSSH 2030;	Zyrtari përgjegjës për hartimin e politikës Zyrtari përgjegjës për hartimin e politikës	Janar-Dhjetor 2024

	Raportet për zbatim të planeve strategjike				Monitorimi i hartimit.	Zyrtari përgjegjës për monitorim (DZhSSH)	Janar-Dhjetor 2024
Mungesa e standardeve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore	Zbatimi i standardeve të OBSH	8	8	64	Zbatimi i planit për hartimin e UPK	Udhëheqësi i DZhSSH	Janar-Dhjetor 2024
					Ndryshimi i UA për hartim të UPK	Zyrtari përgjegjës për hartimin e politikës	Qershor 2024
Mos zbatimi i projekteve kapitale	Zbatimi i kornizës ligjore dhe operacionale	8	8	64	Vlerësimi i nevojës për investim;	Udhëheqësi i DZhSSH	Janar - Dhjetor 2024
					Përcaktimi i kritereve për projekte kapitale;	Udhëheqësi i Divizionit të Infrastrukturës	
Planifikimi dhe menaxhimi financiar	Plani i prokurimit;	7	8	56	Hartimi i detajuar i Planifikimit Final të Prokurimit;	Udhëheqësi i Divizionit të prokurimit;	Janar-Dhjetor 2024
					Hartimi i kërkesave me specifikimin e duhur teknik, kriteret e kualifikimit dhe parashikimi i duhur i çmimeve;	Udhëheqësi i Divizionit të prokurimit; Zyrtarët autorizues	

		Raportet për zbatim të planit				Monitorimi i zbatimit të planit të prokurimit.	Udhëheqësi i Divizionit të prokurimit; Zyrtarët autorizues	
Mos planifikimi dhe ekzekutimi adekuat i buxhetit		Intervenimet dhe përmirësimet	5	8	40	Përcjellja mujore e pagesave në kapitale;	Zyrtari përgjegjës (Divizioni i Financave)	Janar-Dhjetor 2024
						Raportim i Ekzekutimit të penalltive;	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit; Menaxheri i kontratës	Janar-Dhjetor 2024
						Planifikimi i Buxhetit në detale	Udhëheqësi i Divizionit të Financave	Mars - Qershor 2024
						Barazimi ditorë i zyrtarit për barazime dhe njoftimi i me njëherësh i mbikëqyrësit në MFPT në rast të mos barazimit	Zyrtari përgjegjës i Divizionit të Financave	Janar-dhjetor 2024
Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve	Ndikimi Politik në rekrutimin e stafit	Zbatimi i kornizës ligjore dhe institucionale	8	8	64	Zbatimi i parimit të meritës	Divizioni i personelit	Janar - Dhjetor 2024

	Mos njohja me rregullat/praktikat në fushat kryesore të mbrojtjes së integritetit	Intervenimet dhe përmirësimet	7	8	56	Zhvillimi i stafit përmes trajnimeve adekuatë, njoftimit zyrtar, publikimit në ueb faqe dhe fushatave vetëdijësuese	Divizioni i personelit	Janar-Dhjetor 2024
	Mos deklarimi i konfliktit të interesit	Zbatimi kornizës ligjore	7	8	56	Hartimi i PSO për deklarim të konfliktit të interesit	Zyrtari përgjegjës për hartimin e PSO	Tetor 2024
	Vonesat në hartimin e rregulloreve të brendshme për sistematizimin e vendeve të punës	Zbatimi i rregullores në fuqi	5	8	40	Procedimi për miratim i rregullores së brendshme	Zyrtari përgjegjës për hartimin e politikës	Janar-Dhjetor 2024
Komunikimi dhe informimi	Mungesa e planit të komunikimit	Komunikimi bazuar në nevoja	5	8	40	Hartimi i planit të komunikimit	Divizioni i komunikimit	Qershor 2024
	Mungesa e PSO për ngritjen e përgjegjësisë, transparencës përmes komunikimit brenda ministrisë	Mbështetja në ekspertizën e Divizionit për informim	5	8	40	Hartimi i PSO për ngritjen e përgjegjësisë, transparencës përmes komunikimit brenda ministrisë	Zyrtari përgjegjës për hartimin e PSO	Qershor 2024
	Mungesa e monitorimit dhe vlerësimit të komunikimit të brendshëm	Zhvillimi i anketës me personel	5	8	40	Zhvillimi i vlerësimit të rregullt për komunikimin e brendshëm	Zyrtari përgjegjës për monitorim	Janar Dhjetor 2024

	Mos publikimi i rezultateve të zbatimit të masave të integritetit	Hartimi i raportit për zbatimin e planit të integritetit institucional	5	8	40	Publikimi i raportit për zbatimin e planit të integritetit	Koordinatori i Planit të Integritetit	Janar Dhjetor
Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve	Mungesa e pasqyrës së sakte të morbiditetit dhe mortalitetit	Vendim marrja bazuar në raporte zyrtare	7	8	56	Ngritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies për raportim	Drejtori I IKSHPK	Janar Dhjetor 2024
	Mos shfrytëzimi i modulit për burime njerëzore	Shfrytëzimi i SISh bazik;	7	8	56	Popullimi me të dhëna të moduleve ekzistuese	DSISh	
			7	8	56	Zhvillimi i trajnimeve për shfrytëzimin e modulit për burime njerëzore	DSISh	
			7	8	56	Organizmi i tryezave me IKSHPK dhe institucione shëndetësore	DSISh	
	Mos shfrytëzimi i SMSF	Shfrytëzimi i burimeve tjera për burime njerëzore	7	8	56	Zhvillimi i trajnimeve për shfrytëzimin e modulit SMSF	DSISh	
		Intervenimet në planifikim të barnave	7	8	56	Organizmi i tryezave me drejtoritë	IKShPK	

					komunale për shëndetësi		
	Shfrytëzimi i raporteve zyrtare	7	8	56	Hartimi i Planit strategjik për zhvillimin e SISH	Zyrtari përgjegjës për hartimin e Planit	Qershor 2024
	Shfrytëzimi i SISH bazik	7	8	56	Popullimi i moduleve ekzistuese me të dhëna	IKSHPK	Janar-dhjetor 2024
Zbatimi i planit të strategjik të SISH sipas rekomandimeve të SF.					DSISH		
Mungesa e analizës së Rreziqeve për SISH	Rregulloret aktuale të ASH	8	8	64	Zhvillimi i analizës së rreziqeve në SISH	DSISH	Qershor-Tetor
					Përmirësimi i sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të tij		Qershor - dhjetor

Fushat e veçanta të rrezikut								
Regjistrimi i rrezikut		Vlerësimi dhe matja e			Veprimi ndaj rrezikut			
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Vlerësimi i rrezikut			Masat propozuara për / e zvogëlimin eliminimin rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati
			Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut			
Prokurimi publik dhe menaxhimi i projekteve/kontratave	Mos planifikimi i duhur	Intervenimet dhe plotësimet në planin e prokurimit	8	8	64	Rishikimi i Planifikimit të Prokurimit	Udhëheqësi i Divizionit të prokurimit	Qershor 2024
	Neglizhenca për inicim te aktiviteve	Njoftimi për vonesa në inicimin e aktiviteve ne përputhje me planin e prokurimit	8	8	64	Paralajmërimi për inicimin e aktiviteve ne përputhje me planin e prokurimit	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit	Janar - Dhjetor 2024
	Hartimi jo i duhur i kërkesave për tenderim	Adaptimi dhe përmirësimi i kërkesave	8	8	64	Hartimi i kërkesave për tenderim me specifikimin e duhur teknik, kriteret e kualifikimit dhe parashikim të duhur të çmimeve.	Njësia kërkuese	
	Mos përputhje me çmimet e parashikuara dhe tregut		8	8	64			

Dëmtimi i imazhit të institucionit për nivelin e ultë të zbatimit të projekteve kapitale	Hartimi i raporteve	8	8	64	Publikimi i raporteve dokumenteve dhe kontratave të prokurimit	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit
	Insistimi i inicimit të aktiviteteve kapitale në përputhje me UA 04/2009 dhe UA 06/2009	8	8	64	Zbatimi i udhëzimeve UA 04/2009 dhe UA 06/2009 (Definimi i projekteve kapitale) dhe UA 06/2009 (Kriteret e përzgjedhjes dhe prioritizimi i projekteve kapitale)	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit
Mos kontraktimi	Mos komunikimi i duhur mes anëtareve të komisionit vlerësues dhe Div. të Prokurimit	8	8	64	Përmirësimi i komunikimit	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit
Ndërprerja e kontratës	LPP dhe Rregullorja për prokurim publik	8	8	64	Trajnimi i menaxherëve të kontratave	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit

	Mos vlerësimi i tenderëve në kohë në përputhje me dispozitat e LPP-së	LPP dhe Rregullorja për prokurim publik	8	8	64	Trajnimi zyrtarëve për vlerësimin e tenderëve	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit	
Furnizimi me barna	Mos planifikimi i mirëfilltë nga institucionet shëndetësore të KPSH	Intervenimit për përmirësim të kërkesave që tejkalojnë nevojat reale	8	8	64	Planifikimi i barnave në SMSF	Udhëheqësi i Divizionit të Farmacisë	Janar-Dhjetor 2024
	Mungesa e barnave në institucione shëndetësore	Sigurimi i barnave bazuar në nevoja	8	8	64	Planifikimi obligator i të gjitha produkteve në listën esenciale		
	Sasitë e vogla të planifikim nga institucionet shëndetësore të KPSH për disa produkte të listës esenciale që konsiderohen jo të favorshme nga operatorë ekonomik për oferta dhe kontraktim	Intervenimit për përmirësim të kërkesave që nuk paraqesin nevojat reale	8	8	64	Krijimi i politikave favorizuese për rritje të interesimit të kompanive farmaceutike për regjistrim të barnave.	ZKA	Tetor 2024

Jo stabilitet i tregut për produkte farmaceutik të listës esenciale	Krijimi i mundësisë për negociim të drejtpërdrejtë me prodhues farmaceutik	8	8	64	Lidhja e kontratave kornizë	Udhëheqësi i Divizionit të Farmacisë	
Mos përmbushja e detyrimeve ligjore nga ana e operatorëve ekonomik	Marrja e masave administrative	8	8	64	Lëshimi i referencave negative për operatorët ekonomik të papërgjegjshëm	Udhëheqësi i Divizionit të Farmacisë	Janar-Dhjetor 2024
	Marrja e masave administrative	8	8	64	Zhvillimi i fushatave informuese për publikun rëndësinë furnizimit me barna në rrethanat e Kosovës	Divizioni i Komunikimit me Publikun	
Procedurat ankimore të tej zgjata në OShP	Shfrytëzimi i hapësirave ligjore për blerje emergjente	8	8	64	Komunikimi i rregullt me OSHP në lidhje me rëndësinë furnizimit me barna	Udhëheqësi i Divizionit të Farmacisë	

	Mos ofertimi i operatorëve ekonomik në proces të tenderimit	Identifikimi i operatorëve ekonomik që nuk ofertojnë	8	8	64	Krijimi i mekanizmit për inkurajimin e aplikimit të operatorëve ekonomik pa marrë parasysh leverdinë ekonomike	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit	Shtator 2024
	Humbje reputacionit	Njoftimi i opinionit publik për furnizim me barna	8	8	64	Komunikimi i rregullt me publikun në rast se tenderët për furnizim me barna përfundojnë në procedura të ankesave	Divizioni i Komunikimit me Publikun	Janardhjetor 2024
Inspektimi	Mungesa e duhur e mbikëqyrjes dhe monitorimi i subjekteve/institucioneve dhe profesionistëve shëndetësor që ofrojnë shërbime shëndetësore, shërbimeve farmaceutike dhe sanitare	Ligji për inspektoratin shëndetësor	8	8	64	Plotësim Ndryshimi i Ligjit për Inspektoratin shëndetësor Inspektime mirë të planifikuara dhe sipas rasteve të paraqitura	Inspektorati Shëndetësor / Inspektorati Farmaceutik/ Inspektorët Sanitar	Janardhjetor 2024
	Mungesa e resurseve njerëzore për inspektime	Shfrytëzimi racional i inspektorëve	8	8	64	Rritja e numrit të inspektoreve shëndetësor dhe sanitar		

	Mbështetja administrative dhe ligjore nga Ministria				Angazhimi i zyrtarëve ligjor të përhershëm në inspektorat		Tetor 2024
					Nënshkrimi i memorandumit për përmbarimin e kundërvajtjeve inspektuese		Qershor 2024
Vonesat në ekzekutim të kundërvajtjeve inspektuese	Regjistrimi manual i inspektimeve	8	8	64	Krijimi i modulit elektronik për inspektime	SISh	Tetor 2024